AKT NORMATIV
Nr. 9, datë 22.3.2021

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FURNIZIMIT, NDËRMJET MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK DHE DISTRIBUTORIT TË AUTORIZUAR "KEYMEN ILAÇ SANAYI VE TICARET" A.Ş

(Ndryshuar me aktin normativ nr. 14, datë 7.4.2021[1])

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Miratimi i tekstit të marrëveshjes
(shtuar fjalë me aktin normativ nr. 14, datë 7.4.2021)

1. Miratimin e tekstit të marrëveshjes ndërmjet, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar *"Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret" A.Ş.*, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 *(Vero Cell) Coronavac*, të krijuar nga *Sinovac Life Science Co Ltd.* dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës *dhe vaksinën CoronaVac 600 SU IM Suspension për injeksion të paketuar në një flakon 0,5 ml, e cila përmban substancën aktive antigjenin viral "Sars-CoV-2", të inaktivizuar, të zhvilluar nga Sinovac Life Sciences Co., Ltd., prodhuar në Republikën Popullore të Kinës dhe që paketohet në Republikën e Turqisë*, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

2. Marrëveshja për furnizimin ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe *"Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret" A.Ş.*, për shkak të sekretit tregtar dhe kërkesës së shprehur në marrëveshje nga *"Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret",* nuk do të publikohet në asnjë *website* të institucioneve apo në Fletoren Zyrtare.

3. Të gjitha institucionet e përfshira në dhënien e mendimit, të miratimit apo që janë pjesë e procesit kanë detyrimin të mos bëjnë publike marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ apo pjesë të saj.

4. Detyrimet e organeve shtetërore dhe përjashtimet nga detyrimet për furnizimin e vaksinës anticovid, të përcaktuara në aktin normativ nr. 1, datë 10.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, janë të njëjta edhe për furnizimin e vaksinës së inaktivizuar kundër COVID-19 *(Vero Cell), Coronavac* të krijuar nga *Sinovac Life Science Co Ltd.* dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës, të furnizuar për Shqipërinë nga *Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret A.Ş.,* sipas kushteve të tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij akti normativ.

Neni 2
Efektet financiare

Efektet financiare, që rrjedhin nga marrëveshja bashkëlidhur këtij akti normativ, përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2021.

Neni 3
Hyrja në fuqi

[1] Akti normativ nr. 14, datë 7.4.2021 është miratuar me ligjin nr. 57/2021, datë 7.5.2021.

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama